



NXËNËSIT E NOTËS APO TË DIJES?

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2026



AUTOR
Vilson Blloshmi

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	METODOLOGJIA	3
3	TRAJEKTORJA E NOTAVE TË MATURANTËVE (2015-2025)	4
4	DIFERENCA NDËRMJET NOTËS MESATARE VJETORE DHE NOTËS SË MATURËS SHTETËRORE, 2015-2025	6
5	PERFORMANCA NË MATURËN SHTETËRORE SIPAS LËNDËVE	10
6	PERFORMANCA NË MATURËN SHTETËRORE SIPAS ZVAP	14
7	PERFORMANCA NË MATURËN SHTETËRORE SIPAS INSTITUCIONEVE ARSIMORE	17
Q	GJETJET KRYESORE	21
✓	REKOMANDIMET	23
≡	ANEKS	24



1 HYRJE

Ky raport synon të analizojë zhvillimet dhe tendencat e performancës së maturantëve shqiptarë gjatë periudhës 2015-2025, duke u fokusuar në marrëdhënien ndërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të realizuar gjatë tre viteve të studimit në institucionet e arsimit të mesëm të lartë dhe rezultateve të arritura në Maturën Shtetërore. Analiza do të shqyrtojë nëse notat e përfituara gjatë tre viteve të gjimnazit reflektohen në rezultatet e një procesi kombëtar vlerësimi.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet diferencës ndërmjet notës mesatare dhe notës mesatare të Maturës Shtetërore, si një tregues që mund të evidentojë ndryshime në standardet e vlerësimit ndërmjet institucioneve. Diferenca të mëdha ndërmjet këtyre dy treguesve mund të sinjalizojnë nevojën për një analizë më të thelluar të praktikave të vlerësimit.

Raporti do të analizojë gjithashtu performancën sipas institucioneve, territorit, profilit të shkollës, gjinisë, me qëllim identifikimin e modeleve të pabarazisë ose përqendrimit të rezultateve të larta në zona apo institucione specifike.

Sistemi arsimor përdor dy forma kryesore të matjes së arritjeve të nxënësve, vlerësimin e vazhdueshëm gjatë viteve të shkollimit dhe provimet kombëtare përfundimtare. Ndërsa nota mesatare e tre viteve të gjimnazit reflekton performancën e nxënësit përgjatë një periudhe të gjatë dhe përfshin komponentë të ndryshëm të vlerësimit, Matura Shtetërore ofron një standard të përbashkët kombëtar për të gjithë maturantët.

Ky raport synon të analizojë shkallën e përputhshmërisë ndërmjet këtyre dy mekanizmave të vlerësimit, duke identifikuar tendencat kryesore dhe ndryshimet ndërmjet institucioneve. Një objektiv i rëndësishëm është evidentimi i rasteve ku rezultatet e shkollës dhe ato të provimeve kombëtare shfaqin diferenca të konsiderueshme.

2 METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë analizë do të jetë sasiore dhe do të mbështetet në përpunimin dhe krahasimin e të dhënave administrative për arsimin e mesëm të lartë dhe rezultatet e Maturës Shtetërore. Burimi kryesor i të dhënave do të jenë raportet vjetore dhe databazat zyrtare të institucioneve përgjegjëse për administrimin e arsimit parauniversitar, kryesisht Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Analiza do të mbulojë periudhën 2015-2025. Të dhënat do të analizohen në nivel kombëtar, vendor dhe institucional, duke përdorur tregues statistikorë krahasues. Ndër treguesit që do të analizohen janë nota mesatare e tri viteve të gjimnazit, nota mesatare e provimeve të detyruara të Maturës



Shtetërore dhe diferenca ndërmjet këtyre dy vlerësimeve. Analiza do të përfshijë edhe rezultatet mesatare sipas qyteteve, qytetet ku diferenca ndërmjet mesatares së gjimnazit dhe rezultateve të Maturës është më e madhe, si dhe institucionet e arsimit të mesëm të lartë me rezultatet më të larta.

Të dhënat do të krahasohen nga një vit në tjetrin dhe për të gjithë periudhën 2015-2025, për të evidentuar ndryshimet në rezultatet e nxënësve dhe të institucioneve. Krahasimi do të bëhet edhe ndërmjet qyteteve, institucioneve dhe kategorive të ndryshme të nxënësve, në varësi të të dhënave të disponueshme. Rezultatet do të paraqiten përmes tabelave dhe grafikëve krahasues.

3 TRAJEKTORJA E NOTAVE TË MATURANTËVE (2015-2025)

Rezultatet e Maturës Shtetërore përbëjnë një nga treguesit kryesorë të matjes së cilësisë së përgatitjes së nxënësve në fund të arsimit të mesëm të lartë. Ky seksion do të analizojë ndryshimet në rezultatet kombëtare përgjatë viteve dhe do të identifikojë periudhat me përmirësime ose dobësime të performancës.

Të dhënat statistikore për Maturën Shtetërore të viteve 2024 dhe 2025 japin një pasqyrë të rëndësishme mbi pjesëmarrjen e nxënësve, kalueshmërinë dhe rezultatet e tyre në provimet e maturës. Krahasimi i këtyre dy viteve tregon se, ndonëse në vitin 2025 numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në provime është ulur, niveli i kalueshmërisë është përmirësuar lehtë. Në të njëjtën kohë, rezultatet mesatare kanë shfaqur ndryshime të ndryshme në varësi të lëndës.

Në sesionin e parë të Maturës Shtetërore, në vitin 2024 morën pjesë gjithsej 102,876 nxënës, ndërsa në vitin 2025 morën pjesë 100,351 nxënës. Kjo tregon një ulje prej 2,525 nxënësish, ose rreth 2.45%. Rënia është vërejtur si në arsimin publik, ashtu edhe në atë jopublik. Në arsimin publik numri i pjesëmarrësve ka zbritur nga 85,478 në 83,421 nxënës, ndërsa në arsimin jopublik nga 17,398 në 16,930 nxënës. Pavarësisht kësaj rënieje në pjesëmarrje, kalueshmëria në sesionin e parë është përmirësuar, duke kaluar nga 99.63% në vitin 2024 në 99.78% në vitin 2025.

Për sa i përket rezultateve sipas lëndëve, në vitin 2025 vërehen ndryshime të rëndësishme. Në Gjuhën shqipe dhe letërsi, nota mesatare e provimit të Maturës ka rënë nga 7.29 në vitin 2024 në 6.92 në vitin 2025. Edhe në Matematikë është shënuar një rënie, nga 6.88 në 6.54. Ndërkohë, Gjuha e huaj ka shënuar një përmirësim të dukshëm, pasi nota mesatare është rritur nga 7.41 në 7.87. Përmirësim është vërejtur edhe në lëndën me zgjedhje, ku nota mesatare është rritur nga 7.61 në 7.79. Këto të dhëna tregojnë se rezultatet nuk kanë ndryshuar në të njëjtin drejtim në të gjitha lëndët.



Një ndryshim i rëndësishëm vihet re edhe në notën mesatare vjetore. Në sesionin e parë, kjo notë ka rënë nga 7.64 në vitin 2024 në 7.37 në vitin 2025. Rënia është veçanërisht e dukshme në Matematikë, ku nota mesatare vjetore ka kaluar nga 7.85 në 6.82. Në Gjuhën shqipe dhe letërsi ajo ka rënë nga 7.43 në 7.34, ndërsa në Gjuhën e huaj nga 7.69 në 7.54. Në të kundërt, lënda me zgjedhje ka shënuar një rritje të lehtë, nga 7.58 në 7.76.

Edhe në sesionin e dytë vërehet një situatë e ngjashme. Në vitin 2024 morën pjesë 107,009 nxënës, ndërsa në vitin 2025 numri ra në 103,759. Pra, kemi një ulje prej 3,250 nxënësish, ose rreth 3.04%. Numri i nxënësve në arsimin publik ra nga 89,277 në 2024 në 86,634 në 2025, ndërsa në arsimin jopublik nga 17,732 në 17,125. Megjithatë, edhe në këtë sesion kalueshmëria është përmirësuar, duke u rritur nga 99.42% në vitin 2024 në 99.67% në vitin 2025.

Në sesionin e dytë, Gjuhë shqipe dhe letërsi ka shënuar përsëri një rënie të notës mesatare të Maturës, nga 7.23 në 6.88, ndërsa në Matematikë nota ka rënë nga 6.80 në 6.49. Përkundrazi, Gjuha e huaj ka shënuar një rritje të konsiderueshme, nga 7.34 në 7.81, ndërsa lënda me zgjedhje është rritur nga 7.53 në 7.73. Kështu, edhe në sesionin e dytë, Gjuha e huaj paraqitet si lënda me përmirësimin më të dukshëm të rezultateve, ndërsa Matematika mbetet lënda me notën mesatare më të ulët.

Krahasimi i viteve 2024 dhe 2025 tregon një situatë interesante. Nga njëra anë, numri i nxënësve pjesëmarrës ka ardhur në rënie në të dy sesionet, ndërsa nga ana tjetër kalueshmëria është rritur. Kjo do të thotë se një përqindje edhe më e madhe e nxënësve që kanë marrë pjesë në provime kanë arritur t'i kalojnë ato. Megjithatë, rritja e kalueshmërisë nuk është shoqëruar me një rritje të përgjithshme të notave. Përkundrazi, nota mesatare e Maturës në sesionin e parë ka rënë nga 7.30 në 7.28, ndërsa në sesionin e dytë ka mbetur e pandryshuar në 7.23. Më e dukshme është rënia e notës mesatare vjetore, e cila në sesionin e parë ka kaluar nga 7.64 në 7.37 dhe në sesionin e dytë nga 7.58 në 7.33.

Në dhënat tregojnë se Matura Shtetërore 2025 ka pasur një përmirësim të lehtë të kalueshmërisë, por një rënie të rezultateve mesatare në disa prej lëndëve kryesore. Problematika më e dukshme lidhet me Matematikën, ku si nota e provimit të Maturës, ashtu edhe nota mesatare vjetore kanë pësuar rënie të konsiderueshme. Edhe Gjuha shqipe dhe letërsia ka shënuar rënie të rezultateve. Në të kundërt, Gjuha e huaj dhe lëndët me zgjedhje kanë paraqitur një tendencë pozitive. Prandaj, mund të thuhet se viti 2025 paraqet një rritje të suksesit në aspektin e kalueshmërisë, por jo një përmirësim të përgjithshëm të cilësisë së rezultateve të nxënësve.



Tabela 1. Krahasimi i rezultateve të Maturës Shtetërore sipas lëndëve, 2024-2025

Lënda	Pjesëmarrës	Ndryshimi		Kalueshmëria		Nota Mesatare e Maturës	
	2024	2025				2024	2025
Gjuhë shqipe dhe letërsi	26,761	25,948	↓ 813			99.71%	99.63%
Matematikë	26,744	25,937	↓ 807			99.21%	99.57%
Gjuhë e huaj	26,774	25,954	↓ 820			99.53%	99.77%
Lëndë me zgjedhje	26,730	25,920	↓ 810			99.22%	99.72%

Burimi: Qendra e Shërbimeve Arsimore

4 DIFERENCA NDËRMJET NOTËS MESATARE VJETORE DHE NOTËS MESATARE NË PROVIMIN E MATURËS SHETËRORE SIPAS VITEVE 2015-2025

Ky seksion përbën një nga analizat kryesore të raportit. Diferenca ndërmjet notës mesatare të gjimnazit dhe rezultatit të Maturës Shtetërore do të përdoret si tregues për të matur konsistencën e vlerësimit.

Nota mesatare vjetore e gjimnazit dhe nota mesatare e Maturës Shtetërore përbëjnë dy treguesit kryesorë për vlerësimin e performancës së maturanëve në sistemin arsimor parauniversitar. Nota vjetore pasqyron performancën e nxënësit gjatë tre viteve të gjimnazit, ndërsa nota e Maturës Shtetërore përfaqëson rezultatin e arritur në një proces të standardizuar kombëtar të testimit. Krahasimi ndërmjet këtyre dy treguesve ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të vlerësuar koherencën e sistemit të vlerësimit, besueshmërinë e notave të vendosura nga institucionet arsimore dhe shkallën në të cilën rezultatet e Maturës konfirmojnë performancën e regjistruar gjatë viteve të shkollimit.

Analiza e periudhës 2015-2025 tregon se nota mesatare e gjimnazit ka qenë pothuajse çdo vit më e lartë se nota mesatare e Maturës Shtetërore.

Në vitin 2015, nota mesatare e Maturës ishte 6.33, ndërsa nota vjetore ishte 6.23, duke krijuar një diferencë prej +0.10 pikësh në favor të Maturës. Në vitin 2016, situata u përmbys, me notën e Maturës në 5.98 dhe notën vjetore në 6.30, duke rezultuar në një diferencë prej -0.32 pikësh. Në vitin 2017, Matura ishte sërish më e lartë, 6.53 kundrejt 6.39 të notës vjetore, me një diferencë prej +0.14 pikësh. Në vitin 2018, dy treguesit ishin shumë pranë njëri-tjetrit, përkatësisht 6.38 në Maturë dhe 6.43 në vlerësimin vjetor, me një diferencë minimale prej -0.05 pikësh.

Në vitin 2019, hendeku u zgjerua më tej në favor të notës vjetore. Nota e Maturës ishte 6.35, ndërsa nota vjetore 6.81, duke krijuar një diferencë prej -0.46 pikësh. Viti 2020 paraqet një ndryshim të fortë në drejtim të kundërt.



Nota mesatare e Maturës arriti në 7.52, ndërsa nota vjetore ishte 6.69, duke krijuar diferencën më të madhe pozitive të të gjithë periudhës, prej +0.83 pikësh.

Në vitin 2021, nota vjetore u rikthye mbi atë të Maturës, me 6.75 kundrejt 6.40, ndërsa në vitin 2022 Matura ishte përsëri më e lartë, me 6.91 kundrejt 6.74. Në vitin 2023, të dy treguesit pothuajse u barazuan: nota e Maturës ishte 6.69, ndërsa nota vjetore 6.72. Diferenca prej vetëm -0.03 pikësh është ndër diferencat më të vogla të gjithë periudhës.

Ndryshimi më i madh negativ shfaqet në vitin 2024. Në këtë vit, nota mesatare e Maturës ishte 6.80, ndërsa nota vjetore arriti në 7.79, duke krijuar një diferencë prej -0.99 pikësh. Në vitin 2025, diferenca u ngushtua ndjeshëm, por mbeti negative. Nota e Maturës ishte 6.49, ndërsa nota vjetore 6.78, me një diferencë prej -0.29 pikësh.

Tabela 2. Krahësimi i notës mesatare të Maturës Shtetërore me notën mesatare vjetore, 2015-2025

Viti	Nota e Maturës	Nota vjetore	Diferenca
2015	6.33	6.23	+0.10
2016	5.98	6.30	-0.32
2017	6.53	6.39	+0.14
2018	6.38	6.43	-0.05
2019	6.35	6.81	-0.46
2020	7.52	6.69	+0.83
2021	6.40	6.75	-0.35
2022	6.91	6.74	+0.17
2023	6.69	6.72	-0.03
2024	6.80	7.79	-0.99
2025	6.49	6.78	-0.29

Burimi: Qendra e Shërbimeve Arsimore

Kur periudha 2015-2025 shihet në tërësi, nuk shfaqet një model i pandryshueshëm në marrëdhënien midis notës vjetore dhe rezultatit të Maturës Shtetërore. Në katër nga 11 vitet, nota e provimeve të Maturës Shtetërore ka qenë më e lartë se nota vjetore, ndërsa në shtatë vite nota vjetore ka qenë më e lartë se nota e Maturës.

Konkretisht, Matura ka qenë më e lartë në vitet 2015, 2017, 2020 dhe 2022. Në të kundërt, nota vjetore ka qenë më e lartë në vitet 2016, 2018, 2019, 2021, 2023, 2024 dhe 2025. Kjo do të thotë se gjatë pjesës më të madhe të periudhës së analizuar, rezultati i vlerësimit vjetor ka qenë mbi rezultatit mesatar të Maturës.


Në një mesatare të thjeshtë të viteve, nota e Maturës për periudhën 2015-2025 rezulton rreth 6.58, ndërsa nota vjetore rreth 6.69. Diferenca mes



tyre është rreth 0.11 pikë në favor të notës vjetore. Megjithatë, kjo mesatare e përgjithshme duhet interpretuar me kujdes, pasi ajo fsheh luhatje shumë të mëdha midis viteve. Diferenca prej 0.11 pikësh në të gjithë periudhën nuk do të thotë se hendeku ka qenë konstant; përkundrazi, të dhënat tregojnë se ai ka lëvizur nga +0.83 në vitin 2020 deri në -0.99 në vitin 2024.

Kjo është një gjetje e rëndësishme për analizën e sistemit të vlerësimit. Nëse nota vjetore dhe nota e Maturës do të shiheshin si dy matje të ndryshme të performancës së nxënësit, një diferencë e vogël do të sugjeronte një përputhje më të madhe midis performancës së akumuluar gjatë viteve të gjimnazit dhe performancës në provimin standardizues. Në të kundërt, diferencat më të mëdha tregojnë se këto dy mënyra vlerësimi kanë prodhuar rezultate dukshëm të ndryshme në vite të caktuara.

Në disa vite rezultati i Maturës është më i lartë, ndërsa në vite të tjera nota vjetore është më e lartë. Nga 11 vite:

4**vite me rezultat më të lartë në Maturë****7****vite me notë vjetore më të lartë**

Në shumicën e periudhës së analizuar, nota vjetore rezulton më e lartë se nota e Maturës. Mesatarisht për gjithë periudhën, nota e Maturës është rreth 6.58, ndërsa nota vjetore rreth 6.69. Në një mesatare të thjeshtë të viteve, nota vjetore rezulton rreth 0.11 pikë më e lartë.

Pesë vitet e para të periudhës paraqesin një situatë relativisht të luhatshme, por përgjithësisht me diferenca më të moderuara krahasuar me vitet që pasojnë. Në vitin 2015, Matura ishte 0.10 pikë mbi notën vjetore. Një vit më pas, në 2016, nota vjetore ishte 0.32 pikë më e lartë se nota e Maturës. Në 2017, Matura përsëri kaloi mbi notën vjetore, por me një diferencë të vogël prej 0.14 pikësh.



Në vitin 2018, diferenca u reduktua pothuajse në zero. Nota e Maturës ishte 6.38 dhe nota vjetore 6.43, duke krijuar një hendek prej vetëm 0.05 pikësh. Kjo tregon një përputhje relativisht të madhe midis dy treguesve në këtë vit.

Ndryshimi më i dukshëm në këtë fazë ndodh në 2019. Nota vjetore arriti në 6.81, ndërsa nota e Maturës ishte 6.35. Diferenca prej -0.46 pikësh është dukshëm më e madhe se në vitet 2015, 2017 dhe 2018. Kështu, 2019 shënon një zgjerim të rëndësishëm të hendekut në favor të notës vjetore, përpara ndryshimit shumë të fortë që do të shfaqej në vitin 2020.

Në fillim, diferenat janë relativisht të vogla. Në 2015 Matura del 0.10 pikë mbi notën vjetore, ndërsa në 2016 situata kthehet në favor të notës vjetore, me -0.32. Në 2017 Matura rikthehet pak më lart (+0.14), por në 2018 dy treguesit pothuajse barazohen. Ndryshimi më i dukshëm në këtë pjesë ndodh në 2019, kur nota vjetore është 0.46 pikë më e lartë se nota e Maturës. Viti 2019 mund të shihet si një pikë e rëndësishme në tranzicionin drejt një hendeku më të madh negativ.

Viti 2020 përbën një pikë kthese në serinë e të dhënave. Ndërsa në vitin 2019 nota vjetore ishte 0.46 pikë më e lartë se nota e Maturës, në vitin 2020 raporti ndryshon në mënyrë të menjëhershme dhe të fortë, duke kaluar në +0.83 pikë në favor të Maturës.

Kjo do të thotë se brenda vetëm një viti diferenca midis dy treguesve ndryshoi me 1.29 pikë. Në të njëjtën kohë, nota e Maturës u rrit nga 6.35 në vitin 2019 në 7.52 në vitin 2020, ndërsa nota vjetore u ul nga 6.81 në 6.69.

Ky është një ndryshim shumë i rëndësishëm, jo vetëm për shkak të madhësisë së diferencës, por edhe sepse ndryshimi ndodh në të dy treguesit në drejtime të ndryshme. Për këtë arsye, viti 2020 kërkon trajtim të veçantë në çdo analizë të tendencave të Maturës, pasi rezultati i tij ndikon ndjeshëm edhe në mesataret e përgjithshme të periudhës.

Brenda vetëm një viti, diferenca ndryshon me 1.29 pikë. Për më tepër, nota e Maturës rritet nga 6.35 në 2019 në 7.52 në 2020, ndërsa nota vjetore ulet nga 6.81 në 6.69. Ky është një ndryshim shumë i fortë në raportin midis dy mënyrave të vlerësimit.

Viti 2024 përbën rastin më të rëndësishëm në drejtimin negativ të diferencës. Në vitin 2023, diferenca ishte vetëm -0.03 pikë. Një vit më vonë, ajo arrin në -0.99 pikë. Në të njëjtën kohë, nota e Maturës rritet nga 6.69 në 6.80, pra vetëm 0.11 pikë, ndërsa nota vjetore rritet nga 6.72 në 7.79, ose me 1.07 pikë. Kjo do të thotë se zgjerimi i hendekut në vitin 2024 lidhet kryesisht me rritjen e fortë të notës vjetore, ndërkohë që rritja e rezultatit të Maturës është shumë më e kufizuar. Krahësuar me vitin paraardhës, diferenca ndryshon nga -0.03 në -0.99, duke u zgjeruar me 0.96 pikë.



Dy vite dallohen qartë nga pjesa tjetër e serisë, 2020 dhe 2024. Ato përfaqësojnë dy situata të kundërta dhe janë veçanërisht të rëndësishme për të kuptuar luhatjet e marrëdhënies midis dy treguesve.

Në vitin 2020, nota e Maturës ishte 7.52, ndërsa nota vjetore ishte 6.69. Diferenca prej +0.83 pikësh është diferenca më e madhe pozitive e regjistruar gjatë gjithë periudhës 2015-2025. Kjo do të thotë se, në nivelin mesatar kombëtar, performanca në Maturën Shtetërore ishte ndjeshëm më e lartë se vlerësimi i marrë gjatë vitit shkollor. Diferenca është mjaft e madhe për ta veçuar 2020 nga të gjitha vitet e tjera.

Në drejtimin e kundërt qëndron viti 2024. Në këtë vit, nota vjetore ishte 7.79, ndërsa nota e Maturës ishte 6.80. Diferenca prej -0.99 pikësh është hendeku më i madh negativ i të gjithë periudhës. Pra, në vitin 2024 ekziston një diferencë pothuajse prej një pike të plotë midis vlerësimit vjetor dhe rezultatit të Maturës. Kjo e bën vitin 2024 veçanërisht të rëndësishëm për analiza të mëtejshme, sidomos nëse synohet të kuptohet se si ndryshojnë rezultatet sipas shkollave, lëndëve ose kategorive të nxënësve.

5 PERFORMANCA NË MATURËN SHTETËRORE SIPAS LËNDËVE

5.1. Diferenca ndërmjet Notës Mesatare Vjetore dhe Notës në Provimin e Maturës Shtetërore, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

Analiza e të dhënave të publikuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) për periudhën 2015-2025 tregon se, në shumicën dërrmuese të viteve, nota mesatare e Maturës Shtetërore ka qenë më e ulët se nota mesatare vjetore e gjimnazit. Përjashtim bëjnë vitet 2016, 2022 dhe 2023, kur nota mesatare e Maturës për lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe rezultoi lehtësisht më e lartë se nota vjetore, me diferenca përkatësisht +0.03 dhe +0.19 pikë. Në të gjitha vitet e tjera, hendeku është negativ, duke treguar se maturantët kanë arritur rezultate më të ulëta në provimet kombëtare sesa ato të regjistruara në dëftesat e tyre.

Diferenca më e vogël u regjistrua në vitin 2020, kur nota mesatare e Maturës në lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe ishte vetëm 0.03 pikë më e ulët se nota mesatare e gjimnazit. Ky rezultat lidhet me rrethanat e veçanta të pandemisë COVID-19, gjatë së cilës procesi mësimor dhe organizimi i provimeve u zhvilluan në kushte të jashtëzakonshme. Në kontrast, viti 2019 shënoi hendekun më të madh të evidentuar gjatë gjithë periudhës së analizuar. Nota mesatare e Maturës në lëndën e Letërsisë rezultoi 6.39, ndërsa nota mesatare e gjimnazit ishte 7.44, duke krijuar një diferencë prej 1.05 pikësh. Një ndryshim i tillë është statistikisht i rëndësishëm dhe sugjeron një mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet vlerësimit të vazhdueshëm në shkollë dhe rezultateve të testimit të standardizuar.



Në përgjithësi, analiza ndër vite evidenton se nota mesatare vjetore ka shfaqur tendencë rritëse gjatë dekadës së fundit, ndërsa nota mesatare e Maturës është luhatur më shumë dhe nuk ka ndjekur të njëjtin ritëm. Kjo sjellje e ndryshme e dy treguesve ka bërë që diferenca ndërmjet tyre të mbetet e pranishme pothuajse çdo vit. Në vitin 2025, për shembull, nota mesatare vjetore arriti në 7.29, ndërsa nota mesatare e Maturës në provimin e letërsisë dhe gjuhës shqipe ishte 6.88, duke prodhuar një hendek prej 0.41 pikësh. Edhe pse më i vogël se ai i vitit 2019, ky rezultat vazhdon të tregojë se vlerësimet e shkollave janë, mesatarisht, më të larta sesa performanca e maurantëve në provimet kombëtare.

Nga pikëpamja e politikave arsimore, ekzistenca e një diferencë të vazhdueshme ndërmjet notës vjetore dhe rezultatit të Maturës ngre disa çështje të rëndësishme. Së pari, ajo mund të tregojë se standardet e vlerësimit nuk zbatohen në mënyrë uniforme ndërmjet institucioneve arsimore. Praktikët e ndryshme të vlerësimit, presioni për të ruajtur mesatare të larta apo mungesa e mekanizmave të jashtëm të kontrollit mund të ndikojnë në rritjen artificiale të notave gjatë procesit mësimor. Së dyti, diferenca mund të lidhet edhe me faktin se Matura Shtetërore mat kompetenca përmes testeve të standardizuara, të cilat nuk janë plotësisht të krahasueshme me mënyrën e vlerësimit të përditshëm në shkolla. Së treti, diferenca e konsiderueshme ndërmjet notës mesatare dhe notës së maturës ngre dyshime mbi mundësinë e fiktivitetit në vlerësim. Ky ndryshim i theksuar mund të jetë tregues për nevojën e verifikimit të mëtejshëm të procesit të vlerësimit.

Analiza e të dhënave për ZVAP-të në lëndën e Gjuhës Shqipe evidenton një diferencë të dukshme ndërmjet notës mesatare vjetore të nxënësve dhe notës mesatare të marrë në Maturën Shtetërore. Në nivel kombëtar, nota mesatare vjetore është 7.29, ndërsa nota mesatare e Maturës Shtetërore është 6.88. Për rrjedhojë, diferenca NM-NV është -0.41 pikë. Kjo tregon se, në shkallë vendi, nxënësit kanë performuar mesatarisht 0.41 pikë më ulët në provimin e Maturës Shtetërore krahasuar me vlerësimin e tyre mesatar gjatë vitit shkollor.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është se kjo prirje shfaqet në pjesën dërmuese të ZVAP-ve. Nga 52 ZVAP-të e analizuara, 46 kanë një diferencë negative ndërmjet notës së Maturës dhe notës vjetore, ndërsa vetëm 5 ZVAP kanë diferencë pozitive dhe 1 ZVAP paraqet diferencë zero. Pra, në rreth 88.5% të ZVAP-ve, rezultati i Maturës është më i ulët se nota mesatare vjetore për vitin 2025. Kjo e bën diferencën -0.41 pikë një tregues që meriton vëmendje, pasi nuk kemi të bëjmë me një dukuri të izoluar në zona të veçanta, por me një prirje të përgjithshme.

Diferencat më të mëdha negative evidentohen në disa ZVAP ku hendeku ndërmjet vlerësimit vjetor dhe rezultatit të Maturës kalon një pikë. Rasti më i theksuar është Tropoja, ku nota mesatare vjetore është 6.98, ndërsa nota e



Maturës është 5.83, duke krijuar një diferencë prej -1.16 pikësh. Një situatë e ngjashme paraqitet në Has, ku nota vjetore është 7.86, ndërsa ajo e Maturës 6.73, me diferencë prej 1.13 pikë. Diferenca të konsiderueshme vërehen edhe në Gramsh (-0.98), Prrenjas (-0.97), Kukës (-0.96), Mallakastër (-0.94), Vau i Dejës (-0.93), Tepelenë-Memaliaj (-0.89) dhe Poliçan (-0.84).

Këto rezultate janë veçanërisht interesante për faktin se në disa prej këtyre zonave nota mesatare vjetore është relativisht e lartë. Për shembull, në Has nxënësit kanë një notë mesatare vjetore 7.86, por në Maturën Shtetërore arrijnë në 6.73. Kjo tregon se çështja nuk lidhet vetëm me nivelin e përgjithshëm të arritjeve të nxënësve, por edhe me shkallën e përputhjes ndërmjet mënyrës së vlerësimit gjatë vitit dhe performancës në një provim të standardizuar kombëtar.

Në anën tjetër, një numër shumë i kufizuar ZVAP-sh paraqesin rezultate më të mira në Maturën Shtetërore krahasuar me notën mesatare vjetore. Diferenca më e madhe pozitive është në Skrapar, me +0.37 pikë, ku nota e Maturës është 6.65 kundrejt notës vjetore 6.28. Në Korçë-Pustec diferenca është +0.35, ndërsa në Cërrik +0.12, në Pukë-Fushë Arrëz +0.08 dhe në Mat +0.03. Këto raste janë me interes për t'u analizuar më tej, pasi tregojnë një përputhje më të mirë, madje në disa raste një performancë më të lartë, të nxënësve në provimin e standardizuar.

Diferenca ndërmjet dy rezultateve mund të lidhet me disa faktorë. Nota vjetore përfaqëson një proces të vazhdueshëm vlerësimi, i cili zhvillohet gjatë gjithë vitit dhe mund të përfshijë forma të ndryshme të matjes së arritjeve të nxënësve. Në të kundërt, Matura Shtetërore është një provim i standardizuar, i zhvilluar në kushte të njëjta dhe sipas kërkesave të përcaktuara në nivel kombëtar. Për këtë arsye, është e pritshme që të ketë një diferencë ndërmjet dy treguesve. Megjithatë, fakti që diferenca është negative në 46 nga 52 ZVAP-të sugjeron nevojën për të shqyrtuar më nga afër marrëdhënien ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe atij të standardizuar.

Një aspekt tjetër që duhet marrë në konsideratë është përputhja e procesit mësimor dhe vlerësimit gjatë vitit me kompetencat dhe formatin e kërkuar në provimin e Maturës. Nxënësit mund të kenë rezultate të kënaqshme në vlerësimin e vazhdueshëm, por të hasin më shumë vështirësi në situata ku kërkohet analizë e tekstit, interpretim, argumentim, zbatim i njohurive gjuhësore dhe letrare, si dhe menaxhim i kohës në një provim të standardizuar. Për këtë arsye, analiza e diferencës duhet të shoqërohet me një analizë më të detajuar të rezultateve sipas kompetencave dhe niveleve të vështirësisë së testit.


Në këtë këndvështrim, ZVAP-të me diferencat më të mëdha negative duhet të konsiderohen si zona prioritare për analizë. Veçanërisht rastet e Tropojës dhe Hasit, ku diferenca kalon 1 pikë, kërkojnë një shqyrtim të posaçëm të mënyrës së vlerësimit gjatë vitit, nivelit të kërkesave në testet e brendshme



dhe përgatitjes së nxënësve për provimin e Maturës. Në të njëjtën kohë, ZVAP-të ku diferenca është shumë e vogël ose pozitive mund të shërbejnë si pikë referimi për të identifikuar praktika më efektive të vlerësimit dhe përgatitjes.

Në përfundim, të dhënat tregojnë qartë një hendek ndërmjet performancës së nxënësve në vlerësimin vjetor dhe performancës së tyre në Maturën Shtetërore në lëndën e Gjuhës Shqipe. Në nivel kombëtar, ky hendek është -0.41 pikë, ndërsa shfaqet në rreth 88.5% të ZVAP-ve. Kjo prirje sugjeron nevojën për një harmonizim më të madh ndërmjet standardeve të vlerësimit gjatë vitit dhe kërkesave të provimit të Maturës Shtetërore. Qëllimi nuk duhet të jetë thjesht rritja e notës së Maturës, por siguri që nota vjetore të pasqyrojë sa më saktë nivelin real të kompetencave të nxënësve dhe që procesi mësimor gjatë vitit t'i përgatisë ata në mënyrë të qëndrueshme për kërkesat e vlerësimit të standardizuar.

Nga raportet vjetore të QSHA për MSH në lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe rezultojnë këto mesatare kombëtare për çdo vit të notës së maturës (NM) si dhe notës vjetore (NV):



5.2 Diferenca ndërmjet Notës Mesatare Vjetore dhe Notës në Provimin e Maturës Shtetërore, Matematikë

Analiza e rezultateve të Matematikës për periudhën 2015-2025 tregon një mospërputhje të luhatshme, por të rëndësishme, mes notës vjetore dhe rezultatit në Maturën Shtetërore. Në 7 nga 11 vitet e analizuara, nota vjetore është më e lartë se ajo e Maturës. Hendeku arrin kulmin në vitin 2024, kur nxënësit kanë një notë vjetore mesatare 7.79, krahasuar me 6.80 në Maturë, një diferencë prej 0.99 pikësh. Ndërkohë, 2020 paraqet modelin e kundërt, me Maturën 0.83 pikë mbi notën vjetore. Kjo luhatje tregon se marrëdhënia mes vlerësimit vjetor dhe atij të standardizuar nuk është e qëndrueshme.



Veçanërisht rritja e fortë e notës vjetore në 2024, pa një rritje të krahasueshme të rezultatit në Maturë, përbën një sinjal që meriton analizë të mëtejshme mbi konsistencën e standardeve të vlerësimit.

5.3. Diferenca ndërmjet Notës Mesatare Vjetore dhe Notës në Provimin e Maturës Shtetërore, Gjuha e Huaj

Në këtë seksion do të analizohet diferenca ndërmjet notës mesatare vjetore (NV) dhe notës mesatare të arritur në provimin e Maturës Shtetërore (NM) për lëndën e gjuhës së huaj, të paraqitur sipas 52 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).

Treguesi kryesor i analizës është përsëri diferenca NM-NV. Një diferencë pozitive tregon se maturantët kanë marrë mesatarisht një rezultat më të lartë në provimin kombëtar sesa nota e tyre mesatare gjatë vitit shkollor. Në të kundërt, një diferencë negative tregon se rezultati në provimin e Maturës Shtetërore ka qenë më i ulët se vlerësimi i marrë gjatë procesit shkollor.

Në nivel kombëtar, nota mesatare në provimin e Maturës Shtetërore është 7.81, ndërsa nota mesatare vjetore është 7.53, duke rezultuar në një diferencë prej +0.28 pikësh në favor të rezultatit të Maturës Shtetërore.

6 PERFORMANCA NË MATURËN SHETËRORE SIPAS ZVAP

6.1 Tendanca e përgjithshme

Të dhënat tregojnë se, në shumicën e ZVAP-ve, rezultati mesatar në provimin e Maturës Shtetërore është më i lartë se nota mesatare vjetore. Nga 52 ZVAP të analizuar:

- 39 ZVAP, ose rreth 75%, kanë diferencë pozitive;
- 13 ZVAP, ose rreth 25%, kanë diferencë negative.

Kjo tregon një tendencë të përgjithshme ku maturantët kanë performuar më mirë në provimin kombëtar sesa në vlerësimin mesatar të marrë gjatë vitit shkollor. Megjithatë, madhësia e diferencave ndryshon ndjeshëm nga një ZVAP në tjetrën.

Mesatarja e thjeshtë e diferencave ndërmjet ZVAP-ve është afërsisht +0.29 pikë, pothuajse identike me diferencën kombëtare prej +0.28 pikësh. Kjo sugjeron se tendenca pozitive nuk vjen vetëm nga një numër i vogël njësisish me rezultate shumë të larta, por është relativisht e përhapur në nivel territorial.



6.2. ZVAP-të me diferencat më të larta pozitive

Diferencat më të mëdha pozitive evidentohen në disa ZVAP, ku nota e provimit të Maturës Shtetërore është dukshëm më e lartë se nota mesatare vjetore.

Rasti më i theksuar është Gramshi, me një diferencë prej +2.21 pikësh, ku nota mesatare në provim është 7.92, ndërsa nota mesatare vjetore vetëm 5.70. Ky është devijimi më i madh pozitiv në të gjithë tabelën.

Diferenca të tjera të konsiderueshme vërehen në:

- Belsh: +1.40
- Finiq-Dropull: +1.31
- Poliçan: +1.18
- Rogozhinë: +1.16
- Kolonjë: +1.02
- Has: +0.96
- Lezhë: +0.92
- Patos: +0.88

Këto rezultate tregojnë se në këto ZVAP ekziston një hendek i konsiderueshëm ndërmjet performancës së maturantëve në vlerësimin e brendshëm shkollor dhe rezultatit të tyre në testimin kombëtar.

Në veçanti, rasti i Gramshit meriton vëmendje të veçantë, pasi diferenca prej mbi dy pikësh është shumë më e lartë se mesatarja kombëtare prej +0.28 pikësh. Një diferencë e tillë mund të lidhet me karakteristikat e vlerësimit të brendshëm, nivelin e përgatitjes specifike për provim ose faktorë të tjerë që kërkojnë analizë të mëtejshme.

6.3. ZVAP-të ku nota e Maturës është më e ulët se nota vjetore

Në 13 ZVAP, nota mesatare në provimin e Maturës Shtetërore rezulton më e ulët se nota mesatare vjetore.

Diferenca më e madhe negative është në **Klos**, me **-2.39 pikë**. Në këtë ZVAP, nota mesatare vjetore është 8.82, ndërsa rezultati mesatar në provim është vetëm 6.43. Ky është devijimi më i madh në të gjithë analizën dhe paraqet një kontrast të fortë me tendencën kombëtare.

Diferenca të tjera të theksuara negative janë:

- Përmet-Këlcyrë: -0.89
- Malësi e Madhe: -0.85
- Kuçovë: -0.48
- Roskovec: -0.38



- Bulqizë: -0.33
- Kukës: -0.33
- Malësi e Madhe: -0.24
- Sarandë-Konispol-Delvinë: -0.22

Gjithashtu, diferenca negative më të vogla regjistrohen në Shijak, Berat, Krujë, Cërrik dhe Shkodër.

Në këto raste, rezultati i provimit kombëtar nuk konfirmon në të njëjtin nivel performancën e reflektuar nga notat mesatare vjetore. Veçanërisht Klosi paraqet një rast që duhet analizuar më në detaje, pasi diferenca prej -2.39 pikësh është shumë më e madhe se çdo diferencë tjetër negative dhe sugjeron një mospërputhje të fortë ndërmjet dy formave të vlerësimit.

6.4. Shpërndarja dhe ndryshueshmëria e diferencave

Shumica e ZVAP-ve kanë diferenca relativisht të moderuara. Megjithatë, tabela evidenton edhe disa raste ekstreme. Në total, vetëm 7 ZVAP kanë një diferencë në vlerë absolute prej 1 pikë ose më shumë, çka tregon se devijimet shumë të mëdha janë të përqendruara në një numër të kufizuar njësish. Nga ana tjetër, 13 ZVAP kanë diferenca jo më të mëdha se 0.20 pikë në vlerë absolute, duke treguar një përputhshmëri relativisht të lartë ndërmjet notës vjetore dhe rezultatit të provimit.

Kjo krijon një situatë të dyfishtë: në nivel kombëtar diferenca është relativisht e ulët, vetëm +0.28 pikë, por në nivel lokal ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme. Diferenca lëviz nga -2.39 pikë në Klos deri në +2.21 pikë në Gramsh, pra me një interval total prej 4.60 pikësh.

Megjithatë, analiza sipas ZVAP-ve nxjerr në pah një heterogjenitet të konsiderueshëm territorial. Diferencat nga -2.39 deri në +2.21 pikë tregojnë se mesatarja kombëtare fsheh situata shumë të ndryshme në nivel lokal.

Për këtë arsye, analiza nga institucionet përgjegjëse duhet të fokusohet veçanërisht te ZVAP-të me devijimet më të mëdha, si Gramsh, Klos, Belsh, Finiq-Dropull, Poliçan, Rogozhinë, Përmet-Këlcyrë dhe Malësi e Madhe. Një shqyrtim më i thelluar i këtyre rasteve mund të ndihmojë për të kuptuar nëse diferencat lidhen me praktikën e notimit gjatë vitit, me përgatitjen për provimin e Maturës apo me faktorë të tjerë që ndikojnë në rezultatet e nxënësve.



7 PERFORMANCA NË MATURËN SHTETËRORE SIPAS INSTITUCIONEVE ARSIMORE

7.1. Institucionet e Arsimit të Mesëm të Lartë me rezultatet më të larta

Analiza e gjimnazeve me performancën më të lartë do të mundësojë identifikimin e institucioneve që kanë ruajtur standarde të larta përgjatë viteve. Raporti do të analizojë nëse këto institucione janë të përqendruara në zona të caktuara urbane apo nëse ekziston një shpërndarje më e gjerë territoriale. Rezultatet e Maturës Shtetërore për periudhën 2015-2025 tregojnë një grup relativisht të qëndrueshëm shkollash publike që shfaqen vazhdimisht në nivelet më të larta të performancës. Në mënyrë të veçantë, Sami Frashëri, 28 Nëntori, Petro Nini Luarasi, Ismail Qemali dhe Qemal Stafa përbëjnë bërthamën historike të shkollave publike me performancë të lartë. Në vitet e fundit, këtij grupi i është bashkuar fuqishëm Hermann Gmeiner, e cila në të dhënat e disponueshme për 2024 dhe 2025 del në vendin e parë.

Nga analiza dalin tre karakteristika kryesore:

- Sami Frashëri ka profilin më të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës.
- Hermann Gmeiner ka trendin më të fortë pozitiv në fund të periudhës.
- 28 Nëntori, Petro Nini Luarasi dhe Ismail Qemali kanë një prani të gjatë dhe të përsëritur në grupin e shkollave më të mira.

Duhet theksuar se 2022 nuk është përfshirë në llogaritjet e renditjes së periudhës, pasi nuk disponohet aktualisht të dhënat zyrtare për mesataren e shkollave.

Analiza e rezultateve të Maturës Shtetërore për periudhën 2015-2025 tregon se performanca e shkollave publike nuk është një fenomen statik dhe se renditja e tyre ndryshon ndjeshëm nga një vit në tjetrin. Në këtë analizë, vëmendja nuk është përqendruar vetëm te shkollat që kanë arritur rezultatet më të larta, por edhe te mënyra se si këto rezultate përsëriten ose jo në kohë. Kjo është e rëndësishme sepse një pozicion i lartë në Top 10 të një viti të vetëm nuk është domosdoshmërisht tregues i një performance të qëndrueshme të institucionit.

Për renditjen e përgjithshme, nuk do të ishte metodologjikisht e drejtë të marrim thjesht mesataren e çdo shkolle, sepse jo të gjitha shkollat kanë të dhëna për të njëjtin numër vitesh.

Për këtë arsye, renditja e mëposhtme bazohet në:

- shfaqjen e përsëritur në grupin e shkollave më të mira;
- nivelin e rezultateve;
- vazhdimësinë;
- performancën në fillim dhe në fund të periudhës;



- dhe, kur kemi të dhëna, madhësinë e brezit të maturantëve.

Tabela 3. Gjymnazet me performancën më të lartë në Maturën Shtetërore, 2015-2025

Nr.	Gjimnazi	Qyteti	Vlerësimi për periudhën
1	Sami Frashëri	Tiranë	Shkolla më e qëndrueshme në periudhë
2	28 Nëntori	Shkodër	Performancë shumë e lartë dhe histori e gjatë në elitë
3	Petro Nini Luarasi	Tiranë	Konsistencë shumë e lartë gjatë periudhës
4	Ismail Qemali	Tiranë	Rezultate të larta dhe rikthim i fortë në vitet e fundit
5	Hermann Gmeiner	Tiranë	Rritja më e fortë e viteve të fundit
6	Qemal Stafa	Tiranë	Prani e vazhdueshme në elitën publike
7	Ali Demi	Vlorë-Himarë	Përmirësim dhe rezultate të larta në disa vite
8	Aleksandër Moisiu	Kavajë	Performancë e fortë në gjysmën e parë të periudhës
9	Dhaskal Todri	Elbasan	Prani e përsëritur në renditjet e larta
10	Havzi Nela	Kukës	Rezultate shumë të mira, sidomos 2019-2021

Burimi: Përpunim i autorit

Gjimnazi "Petro Nini Luarasi" paraqet një profil të qëndrueshëm. Nga mesatarja 7.99 në vitin 2015, gjimnazi kalon në 8.17, 8.17, 8.32, 8.085, 8.785, 8.473, 8.36, 8.59 dhe 8.33 në vitet e tjera për të cilat disponohen të dhëna. Edhe pse nuk kryeson çdo vit, rezultatet mbeten pranë grupit të gjimnazeve me mesataret më të larta. Seria shumëvjeçare jep një pamje më të plotë të performancës sesa pozicioni në një vit të vetëm.

Një profil tjetër paraqet gjimnazi "Hermann Gmeiner". Të dhënat tregojnë një rritje nga 8.562 në vitin 2021 në 8.63 në 2023, 8.89 në 2024 dhe 8.97 në 2025. Në dy vitet e fundit të analizës, gjimnazi kryeson renditjen kombëtare të shkollave publike sipas të dhënave të shqyrtuara. Gjimnazi "Hermann Gmeiner" nuk ka të njëjtën seri të gjatë të dhënash si gjimnazet "Sami Frashëri", "28 Nëntori" apo "Petro Nini Luarasi", por rezultatet e viteve të fundit tregojnë rritje të pandërprerë gjatë periudhës së vëzhguar.

Këto raste tregojnë pse përcaktimi i një gjimnazi si "më i miri" vetëm nga renditja e një viti është problematik. Gjimnazet "Sami Frashëri", "28 Nëntori" dhe "Petro Nini Luarasi" dallohen për vazhdimësinë shumëvjeçare, ndërsa gjimnazi "Hermann Gmeiner" për rezultatet dhe rritjen e viteve të fundit. Këta tregues matin karakteristika të ndryshme dhe nuk japin domosdoshmërisht të njëjtën renditje.

Në të dhëna gjenden edhe raste ku një rezultat i lartë nuk përsëritet. Gjimnazi "Naim Frashëri" në Durrës regjistroi mesataren 8.28 në vitin 2017 dhe u pozicionua mes gjimnazeve me rezultatet më të larta. Në vitet e tjera të analizuara nuk ka të njëjtën prani në Top 10. Rezultati i vitit 2017 tregon performancën e atij brezi maturantësh, por nuk mjafton për të përcaktuar ecurinë afatgjatë të gjimnazit.



Gjimnazi "Asim Vokshi" në Tropojë paraqet një rast të ngjashëm. Mesatarja u rrit nga 7.96 në vitin 2017 në 8.28 në 2018, ose me 0.32 pikë brenda një viti. Gjimnazi nuk e ruan më pas të njëjtën prani në renditjet e larta të periudhës së analizuar. Përmirësimi i vitit 2018 është i qartë, por të dhënat nuk lejojnë që ai të trajtohet si një prire shumëvjeçare.

Qarkullimi i gjimnazeve në Top 10 bëhet i dukshëm edhe në vitin 2019. Krahas gjimnazeve që shfaqen rregullisht në renditje, atë vit gjenden gjimnazi "Kostandin Kristoforidhi" në Elbasan me 7.836, gjimnazi "At Shtjefën Gjeçovi" në Kurbin me 7.830 dhe gjimnazi "Oso Kuka" në Shkodër me 7.918. Prania e tyre tregon se rezultatet e larta nuk kufizohen te një grup i pandryshueshëm gjimnazesh. Ajo që i dallon këto raste nga gjimnazet "Sami Frashëri", "28 Nëntori" në Shkodër apo "Petro Nini Luarasi" është frekuenca me të cilën shfaqen mes rezultateve më të larta.

I njëjti fenomen vazhdon në fund të periudhës. Në vitin 2024, në grupin e rezultateve të larta shfaqen gjimnazi "Pjetër Budi" në Mat me 8.30, SHMB Dervişan me 8.32 dhe gjimnazi "Raqi Qirinxhi" me 8.26. Në vitin 2025 hyjnë gjimnazi "Ballagat" në Lushnjë, gjimnazi "Sadik Zotaj" në Selenicë, gjimnazi "Zihni Magani" në Peqin dhe gjimnazi "Hoxhë Zogu" në Tropojë. Ndryshimi i emrave nga një vit në tjetrin tregon se Top 10 nuk përbëhet nga një grup i mbyllur gjimnazesh. Krahas atyre që shfaqen rregullisht, në renditje hyjnë edhe gjimnaze që nuk kanë qenë pjesë e Top 10 në vitet paraardhëse.

Një rast që kërkon trajtim të veçantë është gjimnazi "Sadik Zotaj" në Selenicë. Në vitin 2025 gjimnazi regjistron mesataren 8.40, por kjo mesatare i përket vetëm një maturanti. Matematikisht, rezultati është mesatarja e gjimnazit, por nuk ka të njëjtën bazë krahasimi me mesataren 8.40 të një gjimnazi me dhjetëra apo qindra maturantë. Kur ka vetëm një maturant, mesatarja e gjimnazit është e njëjtë me rezultatin individual të atij nxënësi. Për këtë arsye, numri i maturantëve duhet të merret parasysh krahas notës mesatare.

Gjimnazet e Tiranës kanë prani të përsëritur në Top 10 gjatë periudhës 2015-2025. Gjimnazet "Sami Frashëri", "Petro Nini Luarasi", "Ismail Qemali", "Qemal Stafa" dhe "Hermann Gmeiner" shfaqen në vite të ndryshme mes institucioneve me rezultatet më të larta. Kjo krijon një përqendrim të dukshëm të gjimnazeve të kryeqytetit në pjesën e sipërme të renditjes.

Rezultate të larta regjistrohen rregullisht edhe jashtë Tiranës. Gjimnazi "28 Nëntori" në Shkodër kryesoi renditjen në vitet 2015, 2016 dhe 2019. Në grupet e larta shfaqen në vite të ndryshme edhe gjimnazet "Ali Demi", "Havzi Nela", "Aleksandër Moisiu" dhe "Dhaskal Todri". Në vitet 2024-2025 shtohen gjimnaze nga Mati, Gjirokastra, Korça, Lushnja, Selenica, Peqini dhe Tropoja.

Të dhënat e periudhës 2015-2025 japin një tablo më të gjerë se renditja e një viti të vetëm. Një grup gjimnazesh ruan rezultate të larta për disa vite, disa përmirësojnë rezultatet në fund të periudhës, ndërsa të tjera hyjnë në Top 10



vetëm një herë. Edhe numri i maturantëve ndryshon ndjeshëm mes tyre. Për këtë arsye, krahasimi duhet të marrë parasysh rezultatet në vite, pozicionin në renditje dhe numrin e maturantëve, jo vetëm mesataren e një viti.

7.2 ZVAP-të me diferencën më të madhe ndërmjet notave

Analiza do të identifikojë institucionet ku ekziston hendeku më i madh ndërmjet notave të dhëna gjatë shkollimit dhe rezultateve të provimit kombëtar. ZVAP-të me diferencën më të madhe ndërmjet notës vjetore dhe Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

- Tropojë: nota vjetore 6.98, nota e Maturës 5.83, diferenca -1.16 pikë.
- Has: nota vjetore 7.86, nota e Maturës 6.73, diferenca -1.13 pikë.
- Gramsh: nota vjetore 7.56, nota e Maturës 6.58, diferenca -0.98 pikë.
- Prrenjas: nota vjetore 7.48, nota e Maturës 6.51, diferenca -0.97 pikë.
- Kukës: nota vjetore 7.32, nota e Maturës 6.36, diferenca -0.96 pikë.
- Mallakastër: nota vjetore 7.52, nota e Maturës 6.57, diferenca -0.94 pikë.
- Vau i Dejës: nota vjetore 7.01, nota e Maturës 6.08, diferenca -0.93 pikë.
- Tepelenë-Memaliaj: nota vjetore 7.66, nota e Maturës 6.77, diferenca -0.89 pikë.
- Poliçan: nota vjetore 6.98, nota e Maturës 6.14, diferenca -0.84 pikë.
- Kurbin: nota vjetore 7.37, nota e Maturës 6.59, diferenca -0.78 pikë.

Këto ZVAP paraqesin hendekun më të madh ndërmjet vlerësimit vjetor dhe rezultatit në Maturën Shtetërore, ku në të gjitha rastet nota e Maturës është dukshëm më e ulët. Veçanërisht Tropoja dhe Hasi spikasin me një diferencë mbi një pikë, çka tregon nevojën për një analizë më të thelluar të shkaqeve të kësaj mospërputhjeje.

Diferenca ndërmjet notës vjetore dhe asaj të Maturës duhet të trajtohet si një sinjal për verifikim dhe analizë, dhe jo automatikisht si tregues i mbivlerësimit të nxënësve gjatë procesit mësimor. Rezultati mund të ndikohet nga natyra e ndryshme e dy proceseve të vlerësimit: nota vjetore ndërtohet përgjatë një periudhe më të gjatë dhe mund të përfshijë komponentë të ndryshëm të performancës së nxënësit, ndërsa provimi i Maturës është një vlerësim i standardizuar dhe i njëjtë për të gjithë nxënësit. Megjithatë, kur një ZVAP shfaq në mënyrë të përsëritur një diferencë të konsiderueshme, veçanërisht kur kjo diferencë kalon një pikë, lind nevoja për të shqyrtuar nëse standardet e vlerësimit në shkollë janë të harmonizuara me kërkesat dhe nivelet e arritjes që maten në provimin kombëtar. Në këtë këndvështrim, Tropoja dhe Hasi përbëjnë rastet prioritare për analizë, pasi diferencat përkatëse janë -1.16 dhe -1.13 pikë. Këto rezultate mund të përdoren si pikënisje për një analizë më të detajuar në nivel shkolle, lënde dhe klase, duke krahasuar jo vetëm



mesataren e notave, por edhe shpërndarjen e tyre dhe rezultatet e nxënësve në nivele të ndryshme të performancës.

Tabela 4. ZVAP-të me diferencën më të madhe ndërmjet notës vjetore dhe Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës së Huaj

Renditja	ZVAP	Nota e Maturës	Nota Vjetore	Diferenca (NM-NV)
1	KLOS	6.43	8.82	-2.39
2	GRAMSH	7.92	5.70	+2.21
3	BELSH	8.04	6.64	+1.40
4	FINIQ-DROPULL	9.01	7.70	+1.31
5	POLIÇAN	8.09	6.92	+1.18
6	RROGOZHINË	8.18	7.02	+1.16
7	KOLONJË	7.55	6.54	+1.02
8	HAS	7.82	6.85	+0.96
9	LEZHË	7.86	6.95	+0.92
10	PATOS	7.60	6.72	+0.88
11	MALËSI E MADHE	7.48	8.33	-0.85
12	PËRMET-KËLCYRË	7.32	8.21	-0.89

Burimi: Qendra e Shërbimeve Arsimore

Diferenca më e madhe në favor të Maturës Shtetërore është në Gramsh (+2.21), ndërsa diferenca më e madhe në favor të notës vjetore është në Klos (-2.39).



GJETJET KRYESORE

- 01** Në 7 nga 11 vitet e analizuara, nota mesatare vjetore ka qenë më e lartë se nota e Maturës Shtetërore në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, ndërsa në 4 vite ka ndodhur e kundërta.
- 02** Viti 2020 shënon diferencën më të madhe pozitive të periudhës, me Maturën 0.83 pikë mbi notën vjetore për lëndën e Matematikës.
- 03** Viti 2024 paraqet diferencën më të madhe negative, me notën vjetore 0.99 pikë mbi rezultatin e Maturës, kryesisht për shkak të rritjes së fortë të notës vjetore.
- 04** Në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi, 46 nga 52 ZVAP-të kanë rezultat më të ulët në Maturë se në vlerësimin vjetor, duke treguar se kjo nuk është një dukuri e kufizuar në pak zona.



- 05** Tropoja dhe Hasi kanë diferencat më të mëdha negative në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi, përkatësisht -1.16 dhe -1.13 pikë, duke u dalluar qartë nga pjesa tjetër e ZVAP-ve.
- 06** Në Gjuhën e Huaj, situata është e kundërt, në 39 nga 52 ZVAP-të rezultati i Maturës është më i lartë se nota vjetore, me një diferencë kombëtare prej +0.28 pikësh.
- 07** Gramshi ka diferencën më të madhe pozitive në Gjuhën e Huaj, me +2.21 pikë, pasi nota e Maturës është 7.92 kundrejt 5.70 të notës vjetore.
- 08** Klosi paraqet diferencën më të madhe negative në Gjuhën e Huaj, me -2.39 pikë, pasi nota vjetore është 8.82 ndërsa rezultati i Maturës 6.43.
- 09** Diferenca ndërmjet ZVAP-ve është shumë më e madhe sesa sugjeron mesatarja kombëtare, pasi në Gjuhën e Huaj ajo shkon nga -2.39 pikë në Klos deri në +2.21 pikë në Gramsh.
- 10** Në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi, viti 2019 shënon hendekun më të madh kombëtar, me Maturën 1.05 pikë më të ulët se nota vjetore, ndërsa në vitet 2018 dhe 2023 dy treguesit kanë qenë pothuajse të barabartë.
- 11** Rezultatet e vitit 2025 tregojnë një rritje të kalueshmërisë, por jo një përmirësim të përgjithshëm të rezultateve, pasi mesataret në Gjuhën Shqipe dhe Matematikë ranë, ndërsa u rritën në Gjuhën e Huaj dhe lëndët me zgjedhje.
- 12** Matematika paraqet një marrëdhënie më të luhatshme ndërmjet notës vjetore dhe Maturës, me diferencën më të madhe negative në vitin 2024 (-0.99) dhe diferencën më të madhe pozitive në vitin 2020 (+0.83).
- 13** Shkollat publike me performancën më të qëndrueshme gjatë periudhës janë Sami Frashëri, 28 Nëntori dhe Petro Nini Luarasi, të cilat shfaqen në mënyrë të përsëritur në nivelet më të larta të renditjeve.



- 14 Hermann Gmeiner ka trajektoren më të fortë pozitive në vitet e fundit, duke kaluar nga 8.562 në vitin 2021 në 8.97 në vitin 2025 dhe duke u renditur e para në 2024 dhe 2025.
- 15 Performanca e lartë nuk është e kufizuar vetëm në Tiranë, pasi shkolla si 28 Nëntori në Shkodër, Ali Demi në Vlorë, Havzi Nela në Kukës dhe SHMB Dervişan kanë arritur rezultate shumë të larta.
- 16 Një pjesë e shkollave që hyjnë në Top 10 shfaqen vetëm në një vit, si Naim Frashëri në Durrës dhe Asim Vokshi në Tropojë, duke treguar se një rezultat i lartë njëvjeçar nuk është domosdoshmërisht tregues i performancës së qëndrueshme.
- 17 Rasti i Selenicës tregon rëndësinë e numrit të maturantëve në interpretimin e renditjeve, pasi rezultati 8.40 në vitin 2025 është arritur nga vetëm një maturant dhe për këtë arsye nuk është drejtpërdrejt i krahasueshëm me shkollat me grupe shumë më të mëdha.



REKOMANDIMET

- 1 **Të monitorohen shkollat ku diferenat përsëriten.** Analiza nuk duhet të ndalet te bashkia ose qarku. Kur një shkollë paraqet për disa vite diferenca të mëdha ndërmjet notës vjetore dhe Maturës, institucioni përgjegjës mund të analizojë mënyrën e vlerësimit, rezultatet sipas lëndëve dhe ndryshimet ndërmjet klasave. Monitorimi duhet të synojë korrigjimin e problemit dhe jo penalizimin automatik të shkollës ose mësuesve.
- 2 **Të analizohet edhe rasti i notave vjetore më të ulëta.** Monitorimi nuk duhet të përqendrohet vetëm te rastet kur nota vjetore është më e lartë se Matura. Edhe diferenca e kundërt kërkon analizë. Nëse nxënësit e një shkolle marrin vazhdimisht rezultate më të larta në Maturë sesa gjatë vitit, duhet parë nëse vlerësimi i brendshëm është më i rreptë se standardi kombëtar.



3 Të trajnohen mësuesit për vlerësimin. Trajnimet e mësuesve mund të përqendrohen më shumë te hartimi i testeve, kriteret e pikëzimit dhe lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënës dhe notës. Rezultatet e Maturës mund të përdoren për të përcaktuar shkollat dhe lëndët ku këto trajnime nevojiten më shumë.

4 Të vlerësohet cilësia e pyetjeve të Maturës pas çdo provimi. Pas çdo provimi mature duhet të analizohet se si kanë funksionuar pyetjet e provimit: sa nxënës i kanë zgjidhur, cilat pyetje kanë rezultuar shumë të lehta ose shumë të vështira dhe sa mirë kanë dalluar nivelet e ndryshme të njohurive. Kjo analizë mund të përdoret për përmirësimin e testeve të viteve pasardhëse.

ANEKS

Bazuar në materialin e disponueshëm, shkollat që rezultojnë me vetëm një paraqitje në Top 10 janë:

Shkolla	Viti i paraqitjes	Mesatarja	Komente
Muharrem Çollaku - Pogradec	2015	7.71	Nuk shfaqet më në Top 10
Naim Frashëri - Durrës	2017	8.28	Rezultat i lartë i izoluar
Asim Vokshi - Tropojë	2018	8.28	Ngjitje e fortë, por pa vazhdimësi
Kostandin Kristoforidhi - Elbasan	2019	7.836	Shfaqje vetëm në 2019
At Shtjefën Gjeçovi - Kurbin	2019	7.830	Shfaqje vetëm në 2019
Pjetër Budi - Mat	2024	8.30	Hyn në Top 10 vetëm në 2024
Ballagat - Lushnje	2025	8.47*	Hyrje e re në elitë
Sadik Zotaj - Selenicë	2025	8.40	Rezultat shumë i lartë, por bazë shumë e vogël nxënësish
Zihni Magani - Peqin	2025	8.31	Hyrje e re në Top 10
Hoxhë Zogu - Tropojë	2025	8.30	Hyrje e re në Top 10

Renditja sipas viteve

Viti 2015

Nga tabela zyrtare e QSHA-së, e cila përfshin mesataren e pesë notave të Maturës 2015, renditja sipas vlerës së mesatares është:

Nr.	Shkolla	Mesatarja
1	28 Nëntori - Shkodër	8.56
2	Sami Frashëri - Tiranë	8.30



Nr.	Shkolla	Mesatarja
3	Qemal Stafa - Tiranë	8.25
4	Ismail Qemali - Tiranë	8.08
5	Petro Nini Luarasi - Tiranë	7.99
6	Aleksandër Moisiu - Kavajë	7.88
7	Ali Demi - Vlorë	7.84
8	Muharrem Çollaku - Pogradec	7.71
9	Raqi Qirinxhi - Korçë	7.55
10	Dhaskal Todri - Elbasan	7.35

Viti 2016

Nr.	Shkolla	Mesatarja
1	28 Nëntori - Shkodër	8.35
2	Sami Frashëri - Tiranë	8.27
3	Ismail Qemali - Tiranë	8.22
4	Aleksandër Moisiu - Kavajë	8.22
5	Petro Nini Luarasi - Tiranë	8.17
6	Qemal Stafa - Tiranë	8.04
7	Oso Kuka - Shkodër	7.97
8	Dhaskal Todri - Elbasan	7.90
9	Ali Demi - Vlorë	7.88
10	Muharrem Çollaku - Pogradec	7.86

28 Nëntori mbetet në krye edhe në 2016, por diferenca me Sami Frashërin ngushtohet ndjeshëm.

Vitet 2017-2018

Shkolla	2017	2018
Sami Frashëri	8.51	8.48
28 Nëntori	8.09	8.42
Petro Nini Luarasi	8.17	8.32
Ismail Qemali	8.17	8.30
Ali Demi	8.22	8.38
Qemal Stafa	8.12	8.30
Aleksandër Moisiu	8.14	8.14
Dhaskal Todri	8.11	8.20
Naim Frashëri	8.28	8.16
Asim Vokshi	7.96	8.28



Viti 2019

Nr.	Shkolla	Mesatarja	Maturantë
1	28 Nëntori - Shkodër	8.297	203
2	Sami Frashëri - Tiranë	8.262	479
3	Ali Demi - Vlorë-Himarë	8.097	282
4	Petro Nini Luarasi - Tiranë	8.085	470
5	Havzi Nela - Kukës	8.068	387
6	Ismail Qemali - Tiranë	7.927	532
7	Oso Kuka - Shkodër	7.918	186
8	Kostandin Kristoforidhi - Elbasan	7.836	236
9	Qemal Stafa - Tiranë	7.832	447
10	At Shtjefën Gjeçovi - Kurbin	7.830	253

2019 është veçanërisht interesant sepse 28 Nëntori rikthehet në vendin e parë, ndërsa Sami Frashëri mbetet e dyta. Po ashtu, Havzi Nela hyn në grupin e pesë shkollave kryesore, duke treguar se performanca e lartë nuk është e kufizuar vetëm në Tiranë.

Vitet 2020-2021

Shkolla	2020	2021
Sami Frashëri	8.852	8.508
Qemal Stafa	8.729	8.452
Ismail Qemali	8.639	8.383
Petro Nini Luarasi	8.785	8.473
Ali Demi	8.795	8.285
28 Nëntori	8.665	8.439
Havzi Nela	8.710	8.108
Aleksandër Moisiu	8.640	8.535
Dhaskal Todri	8.639	7.982
Hermann Gmeiner	—	8.562

Viti 2022 ka mungesë e të dhënave

QSHA ka materiale zyrtare për Maturën 2022, por nga informacioni që kemi në dispozicion nuk kemi tabelën e nevojshme për mesataren e Maturës sipas shkollave publike.



Viti 2023

Renditja	Shkolla	Mesatarja
1	Ismail Qemali - Tiranë	8.64
2	Hermann Gmeiner - Tiranë	8.63
3	Qemal Stafa - Tiranë	8.53
4	Sami Frashëri - Tiranë	8.48
5	Ali Demi - Vlorë	8.43
6	Petro Nini Luarasi - Tiranë	8.36
7	28 Nëntori - Shkodër	8.22
8	Dhaskal Todri - Elbasan	8.10
9	Aleksandër Moisiu - Kavajë	7.88
10	Havzi Nela - Kukës	7.75

Viti 2024

Nr.	Shkolla	Mesatarja
1	Hermann Gmeiner - Tiranë	8.89
2	Sami Frashëri - Tiranë	8.72
3	Petro Nini Luarasi - Tiranë	8.59
4	Ali Demi - Vlorë-Himarë	8.58
5	Qemal Stafa - Tiranë	8.53
6	Ismail Qemali - Tiranë	8.45
7	28 Nëntori - Shkodër	8.35
8	SHMB Dervişan - Finiq-Dropull	8.32
9	Pjetër Budi - Mat	8.30
10	Raqi Qirinxhi - Korçë-Pustec	8.26



Viti 2025

Nr.	Shkolla	Mesatarja
1	Hermann Gmeiner - Tiranë	8.97
2	SHMB Dervişan - Fiq-Dropull	8.59
3	28 Nëntori - Shkodër	8.47
4	Sami Frashëri - Tiranë	8.47
5	Ballagat - Lushnje	8.47
6	Sadik Zotaj - Selenicë	8.40
7	Petro Nini Luarasi - Tiranë	8.33
8	Ismail Qemali - Tiranë	8.33
9	Zihni Magani - Peqin	8.31
10	Hoxhë Zogu - Tropojë	8.30



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al